

VENDIM
Nr. 10, datë 25.2.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE
RAJONALE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të programit infrastruktura vendore dhe rajonale, transhi II, i thirrjes së I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, në vlerën 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore dhe rajonale, transhi II (THIRRJA 1)

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit për vitin 2015	Vlera e financimit për vitin 2016
			(lekë)	(lekë)	(lekë)
Qarku Dibër					
1	Bashkia Burrel	Rikonstruksion i fasadave dhe zëvendësimi i ndriçimit në rrugët: "Koke Malci"-Qendër- "Rexhep Pashë Mati", "Kuvendi i Dukagjinit" dhe trotualet për rrugën "Kuvendi i Dukagjinit"	66,508,393	46,555,875	19,952,518
2	Bashkia Bulqizë	Pedonalja e qytetit dhe Unaza e Poshtme	108,000,000	72,535,441	35,464,559
Qarku Elbasan					
3	Bashkia Elbasan	Rikualifikim urban i parkut “Aqif Pasha”	110,000,000	73,935,441	36,064,559
Qarku Fier					
4	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i rrugës pedonale “Abaz Bej Lushnja”	46,034,613	32,224,229	13,810,384
Qarku Vlorë					
5	Bashkia Himarë	Shëtitorja buzë detit Qeparo, faza II	190,000,000	99,812,535	90,187,465
6	Bashkia Sarandë	Ndërtim asfaltim rr. nr. 5, loti II dhe III	348,000,000	170,080,105	177,919,895
7	Bashkia Sarandë	Rikonstruksion i Rrugës së Fermerëve, fshati Metoq	52,000,000	26,000,000	26,000,000
Qarku Korçë					
8	Bashkia Korçë	Zgjatim i bulevardit Republika, rikonstruksion dhe zgjerim i Rrugës Gjon Buzuku, sheshi tek xhamia, sheshi brenda pazarit	100,000,000	70,000,000	30,000,000
Qarku Berat					
9	Bashkia Berat	Rikualifikim dhe rikonstruksion i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale	81,357,637	56,950,346	24,407,291
10	Bashkia Berat	Rikonstruksion i bibliotekës "Vehxhi Buharaja"	35,000,000	24,500,000	10,500,000
11	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i rrugës “Qemal Stafa” dhe “Kristaq Lacka”	141,423,109	67,646,995	73,776,114
Qarku Durrës					
12	Bashkia Durrës	Rrugë mbi kanalin kullues, K-192, Plazh, loti 1	100,218,968	67,088,718	33,130,250
Qarku Shkodër					
13	Bashkia Shkodër	Rikualifikim urban i rrugicave në qendrën historike sheshi “Gjon Pali II-të”	20,707,580	14,495,306	6,212,274
Fondi Shqiptar i Zhvillimit*					
14	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rivitalizimi i ndërtesave dhe shëtitorja e lumit në Tamarë	63,015,374	44,110,762	18,904,612

15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i Rrugës Adë (Karburanti) - Frakull e Vogël, Komuna Frakull	82,273,041	57,591,129	24,681,912
16*	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Levan - Shtyllas, Komuna Levan	126,730,510	69,844,804	56,885,706
17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim i rrugës Tozhgez - Zhelizhan - Mazhaj, komuna Allkaj	98,928,509	66,185,397	32,743,112
18	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i shëtitorës, KUZ, te liqeni i Farkës, Komuna Farkë	90,765,048	63,535,534	27,229,514
19	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Peshtan, Komuna Qendër Tepelene	25,254,944	17,678,461	7,576,483
20*	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rruga e fshatit Goranxi, Komuna Dropull i Sipërm	57,288,131	40,101,692	17,186,439
21	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i kryqëzimit të Shkozës, Bashkia Tiranë	27,324,616	19,127,230	8,197,385
TOTALI			1,970,830,473	1,200,000,000	770,830,472

* Në zbatim të vendimit të KZHR nr.6, datë 9.2.2015, “Për administrimin “tranzitor” të projekteve me autoritet kontraktues komunat, për periudhën shkurt-shtator 2015”.

Shënim

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

2. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i fondit për zhvillimin e rajoneve për vitin 2015.

3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

4. Për projektet e financuara më sipër (specifikisht projektet: 3, 8, 9, 10, 14) ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.

5. Për projektet, me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën e plotë të projektit është përfshirë edhe vlera e supervizimit dhe kolaudimit të projektit.

6. Për projektin me nr. 5 (Shëtitorja Qeparo, faza II, me autoritet kontraktues Bashkinë Sarandë), autoriteti kontraktues duhet të marrë konfirmimin pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si edhe të dërgojë për miratim lejen përkatëse në KKT, përpara zbatimit të projektit.